



RAPORT MONITORIMI JANAR – DHJETOR 2023

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E DREJTËSISË PËR TË MITUR

PRILL 2024

www.drejtesia.gov.al

Përmbajtja

| | |
|---|-------------------------------------|
| SHKURTIME | 3 |
| INFORMACION PËRMBLEDHËS | Error! Bookmark not defined. |
| PËRMBLEDHJE EKZEKTUTIVE | 6 |
| METODOLOGJIA E PËRDORUR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË MONITORIMIT DHE PERFORMANCËS..... | 9 |
| Koordinimi institucional për hartimin e Raportit të Monitorimit dhe Performancës | 10 |
| Periodiciteti i hartimit të Raportit të Monitorimit dhe Performancës..... | 10 |
| Fazat e ndjekura për hartimin e Raportit të Monitorimit dhe Performancës..... | 10 |
| Metodologjia e analizimit të të dhënave për raportin e monitorimit dhe performancës..... | 11 |
| Konsultimi publik i raportit të monitorimit dhe performancës..... | 12 |
| PROGRESI I ECURISË | 13 |
| REFORMAT E ZBATUARA ME SUKSES DHE SFIDAT KRYESORE | Error! Bookmark not defined. |
| PERMBLEDHJE E ARRITJEVE DHE SFIDAVE KRYESORE..... | 13 |
| ANEKSI 1. PROGRESI LIDHUR ME QËLLIMET E POLITIKAVE, OBJEKTIVAT SPECIFIKË & MASAT | Error! Bookmark not defined. |

SHKURTIME

| | |
|---------------|--|
| AKCESK | Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike |
| AKPA | Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive |
| AKSHI | Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit |
| AMA | Autoriteti Mediave Audiovizive |
| AMVV | Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjen Vendore |
| AP | Avokati i Popullit |
| AS | Akademia e Sigurisë |
| ASCAP | Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar |
| ASHDMF | Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës |
| BE | Bashkimi Evropian |
| DAP | Departamenti i Administratës Publike |
| DM | Drejtësia për të Mitur |
| DNJF | Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas |
| DPAP | Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar |
| DPB | Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve |
| DPP | Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit |
| DPPSH | Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit |
| DPSHP | Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës |
| DVP | Drejtoria Vendore e Policisë |
| DHASH | Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë |
| DHKN | Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve |
| IAL | Institucione të Arsimit të Lartë |
| IML | Instituti i Mjekësisë Ligjore |

| | |
|----------------------|--|
| ILD | Inspektori i Lartë i Drejtësisë |
| INSTAT | Instituti i Statistikave i Republikës së Shqipërisë |
| IDP | Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale |
| KDPM | Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur |
| KMD | Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi |
| KLGGJ | Këshilli i Lartë Gjyqësor |
| KLP | Këshilli i Lartë i Prokurorisë |
| KM | Këshilli i Ministrave |
| MAS | Ministria e Arsimit dhe Sportit |
| MB | Ministria e Brendshme |
| MD | Ministria e Drejtësisë |
| MFE | Ministria e Financave dhe Ekonomisë |
| MSHRF | Ministër i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët |
| MSHMS | Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale |
| NJMF | Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës |
| NJQV | Njësitë e Qeverisjes Vendore |
| OSHC | Organizata të Shoqërisë Civile |
| PP | Prokuroria e Përgjithshme |
| PR | Parlamenti Rinor |
| SDM 2022-2026 | Strategjia e Drejtësisë për të Mitur dhe Plani i Veprimit 2022-2026 |
| SIDhDPM | Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur |
| PV | Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur |
| QPKMR | Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve |
| RSH | Republika e Shqipërisë |
| RTSH | Radio Televizioni Shqiptar |
| SASPAC | Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës |
| SHM | Shkolla e Magjistraturës |
| SHSSH | Shërbimi Social Shtetëror |

| | |
|---------------|--|
| TdH | Terre des Homes |
| UNICEF | Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijet |
| UP | Urdhri i Psikologut |
| UPS | Urdhri i Punonjësit Social |
| VKM | Vendim i Këshillit të Ministrave |

DRAFT

I. PËRMBLEDHJE EKZEKTUTIVE

Legjislacioni shqiptar bazohet në parimet e drejtësisë miqësore për fëmijët, e cila ka në thelb të saj garantimin e respektit dhe efektivitetin e zbatimit të të gjithë të drejtave të fëmijëve, në nivelin më maksimal të mundshëm. Kuadri ligjor vendas synon të garantojë elementët e domosdoshëm të drejtësisë miqësore të tillë si: aksesueshmëria, përshtatshmëria, efektiviteti në raport të drejtë me nevojat dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve. Parime të tilla si pjesëmarrja dhe informimi, interesi më i lartë i fëmijës, dinjteti, mbrojtja nga diskriminimi, shteti i së drejtës, qëndrojnë në themel të kuadrit ligjor shqiptar. Drejtësia miqësore përfshin të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të drejtën për pjesëmarrje dhe për të kuptuar procedurat, të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare si dhe të integritetit dhe dinjitetit. Gjithashtu "*interesi më i lartë i fëmijës*" paraqitet si një parim me shtrirje kapilare në gjithë legjislacionin tonë të brendshëm. Kuadri ligjor i drejtësisë për të mitur i është përmbajtur instrumentave ndërkombëtare të ratifikuara dhe është zhvilluar në përputhje me standardet e Konventës së OKB-së "*Për të Drejtat e Fëmijës*", ato të BE-së dhe të Këshillit të Evropës.

Strategjia e Drejtësisë për të Mitur 2022-2026 dhe Plani i saj i Veprimit është strategjia e dytë në fushën e drejtësisë për të mitur. Dokumentet e saj strategjike përfshirë si, Plani i Veprimit dhe Pasaporta e Indikatorëve, u miratuan në me VKM Nr. 892, datë 27.12.2022 dhe zbatimi i saj nisi menjëherë.


Zbatimi efektiv dhe i suksesshëm i "SDM 2022-2026" është arritur përmes një sistemi monitorimi dhe vlerësimi për të verifikuar progresin në plotësimin ose jo të objektivave specifike dhe masave të vendosura në Planin e Veprimit.

Komiteti Drejtues Sektorial/Rrjeti Ndërinstitucional në nivel qendror për çështjet e fëmijëve është grupi ku janë diskutuar çështje të ecurisë së zbatimit të objektivave dhe masave të "SDM 2022-2026" me qëllim realizimin e bashkëpunimi ndërinstitucional me grupet e interesit. Rrjeti Ndërinstitucional në nivel qendror, drejtohet nga Ministria e Drejtësisë dhe ka në përbërje të tij përfaqësues nga institucionet e tjera ligjzbatuese, që janë përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e treguesve në kompetencën e tyre, duke krahasuar objektivat e treguesve të performancës së planifikuar me ata aktualë. Ky rrjet mbështetet në veprimtarinë e tij nga Sekretariati Teknik (ST), i cili do të drejtohet nga Ministria e Drejtësisë.

SDM 2022-2026 parashikon për zbatim gjatë 5 viteve të implementimit të saj 13 Objektiva Specifikë dhe 64 masa për të kontribuar në performancën e 45 indikatorve cilësorë dhe sasiorë. Raporti paraqet gjithashtu një analizë të thellë mbi zbatimin të 45 indikatorëve të parashikuar në Pasaportën e Indikatorëve, lidhur me secilin Qëllim Politik dhe Objektiv Specifik.

DRAFT

II. REALIZIMI I QËLLIMEVE TË POLITIKËS NË VITIN 2023



III. METODOLOGJIA E PËRDORUR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË MONITORIMIT DHE PERFORMANCËS

Metodologjia e Raportit të Monitorimit, përshkruan procesin e ndjekur gjatë hartimit të raportit dhe ka si qëllim kryesor të mundësojë udhëzimet e nevojshme për lehtësimin në kuptueshmërinë e tij, si dhe të orientohet drejt prezantimit të rezultateve kryesore për të nxjerrë në pah arritjet, sfidat dhe rekomandimet e adresuara për përmirësim. Për të siguruar një proces monitorimi bazuar në arritje konkrete, Ministria e Drejtësisë realizon komunikime intensive me përfaqësuesit e strukturave të përfshira në Planin e Veprimit, me qëllim prezantimin e drejtë dhe të qartë të rezultateve dhe problematikave të hasura gjatë periudhës së raportimit. Kështu, gjatë periudhës hartuese, është mbajtur një komunikim i vazhdueshëm (verbal dhe zyrtar) në varësi të specifikave për plotësimin e dokumentave raportues me disa prej institucioneve të përfshira në strategji, me qëllim evidentimin e rasteve të suksesit, të cilat kanë sjellë rezultate të dukshme në veprimtarinë e tyre, gjithashtu identifikimin e sfidave, problematikave dhe komponentëve të cilët kanë ndikuar apo penguar progresin apo zbatimin e aktiviteteve të parashikuara.

Gjithashtu, gjatë periudhës Dhjetor 2023 - Janar 2024, me mbështetjen e UNICEF, në ambientet e MD sipas nje kalendari të aprovuar nga stafi i MD, janë zhvilluar trainime me pjesëmarrjen e të gjitha institucioneve raportuese në lidhje me mënyrën e unifikuar të raportimit të masave/aktiviteteve si dhe pasaportën e indikatorëve.

Ministria e Drejtësisë, harton raporte gjashtëmujore dhe vjetore për monitorimin dhe raportimin e dokumenteve strategjike, të cilët prodhojnë informacion të nevojshëm dhe në kohë për politikëbërësit mbi progresin e zbatimit të masave që janë parashikuar në planin e veprimit të SDM-së për vitet e ardhshme, raporte të cilat publikohen në faqen zyrtare të MD-së.

Ministria e Drejtësisë ka hartuar raportin e monitorimit dhe të performancës për periudhën përkatëse sipas manualit të hedhjes së të dhënave në sistemin IPSIS miratuar me vendimin nr. 290, datë 11.4.2020 “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS).

➤ **Koordinimi institucional për hartimin e raportit të monitorimit dhe performances**

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 128, dt. 08.11.2021 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Drejtësisë”, është ngritur Sektori i Monitorimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave, pranë Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, e cila është struktura përgjegjëse për procesin monitorues si dhe hartimin e Raporteve të Monitorimit të Strategjive. Ky sektor kryen koordinimin me të gjitha institucionet përgjegjëse, si dhe më pas vijon me hartimin e raportit të monitorimit. Raporti i monitorimit të dokumentit strategjik (SDM 2022-2026) për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2023, është hartuar mbi bazën e kontributit të dhënë nga institucionet përgjegjëse dhe kontributore të planit të veprimit.

➤ **Periodiciteti i hartimit të Raportit të Monitorimit dhe Performancës**

Ministria e Drejtësisë, harton raporte gjashtë mujore dhe vjetore për monitorimin dhe raportimin e dokumenteve strategjike, të cilët prodhojnë informacion të nevojshëm dhe në kohë për politikëbërësit mbi progresin e zbatimit të masave që janë parashikuar në planin e veprimit të SDM (2022-2026) për vitet e ardhshme, raporte të cilat publikohen në linkun: www.drejtesia.gov.al/strategjia-ndersektoriale-2/.

➤ **Fazat e ndjekura për hartimin e Raportit të Monitorimit dhe Performancës**

Fazat që janë ndjekur për përgatitjen dhe konsolidimin e raportimit të monitorimit dhe performancës, paraqiten si më poshtë:

- Kërkesa për kontribut në hartimin e raportit u dërgua në datë 15 janar 2024 tek të gjitha institucionet raportuese në përputhje me standardet e sistemit IPSIS dhe Parimet e Mirëqeverisjes;
- Organizimi i trainimeve, me asistencën e UNICEF dhe me pjesëmarrjen e institucioneve raportuese:
 - 1) Trainimi i parë i organizuar në datë 21 dhjetor 2023 me pjesëmarrjen e KLGJ, KLP, PP MD dhe Institucionet e varësisë QPKMR, DNJF, SHP, DPB përfshirë dhe DHKN dhe DHKA.
 - 2) Trainimi i dytë u organizua më datë 9 janar 2024 me pjesëmarrjen e AMA, RTSH, DPP, MAS, MSHFR, KDIMDHP, AP, KMD.
 - 3) Trainimi i tretë u organizua më datë 10 janar 2024 me pjesëmarrjen e MB dhe institucionet e varësisë (DPPSH, Akademia e Sigurisë), SHM
 - 4) Trainimi i katërt u organizua më datë 11 janar 2024 me pjesëmarrjen e MSHMS dhe institucionet e varësisë ASHMDF, SHSSH, Shkolla e magistraturës, UP.
- Hartimi I draftit të parë të raportit të performancës në datën 25 mars 2024;
- Dërgimi për komente shtesë nga institucionet kontribuese në datën 29 mars 2024. Kjo për arsye se disa institucione nuk kishin dërguar inpute ose inputet e dhëna nuk ishin në përputhshmëri me kërkesat e masave dhe objektivave;
- Hartimi i draftit të dytë të raportit në datën 15 prill 2023;
- Publikimi i Raportit Vjetor të Monitorimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë (do vendosim datën).
- Dërgimi i procedurave të mbledhjes të KDS-së (minutat e takimit, konkluzionet operacionale, raporti i konsultimit publik) dhe paketa finale, së bashku me linkun e publikimit për njohje SASPAC datë (do vendosim datën)

➤ Metodologjia e analizimit të të dhënave për raportin e monitorimit dhe performances

Raporti shpreh qartë vlerësimin e arritjeve kryesore duke përdorur grafikë, analiza të thelluara, edhe vizualisht përmes tabelave. Gjithashtu paraqitet qartë identifikimi i shkallës së performancës për Qëllimet e Politikave dhe Objektivët Specifikë.

Analiza mbi progresin e realizimit të Qëllimeve Politike ndjek një qasje të strukturuar. Progresi lidhur me secilin Qëllim Politik është analizuar në përgjithësi sipas Objektivave Specifikë (OS) përkatës. Në vijim, për secilin OS është paraqitur një përmbledhje e rezultateve sasiore dhe cilësore të zbatimit të masave përkundrejt kryerjes së veprimeve për realizimin e tyre nga institucionet përgjegjëse, analiza e risqeve dhe veprimeve për adresimin e tyre (sipas rastit) dhe analiza e treguesve të performancës, nëse kjo ka qenë e mundur mbi bazën e të dhënave të paraqitura nga institucionet përgjegjëse. Prezantimi i rezultateve mbi zbatimin a masave ndjek numërimin e Planit të Veprimit dhe është prezantuar me sfond me ngjyrë sipas nivelit të zbatimit (të zbatuara plotësisht/ të zbatuara pjesërisht/ të pazbatuara). Masat të cilat fillojnë periudhën e zbatueshmerisë pas vitit 2023 janë shënuar me sfond të bardhë.

Përcaktimi i nivelit të zbatimit të masave (në përqindje) është ai i raportuar nga secili institucion përgjegjës, dhe është evidentuar në kontributet e përcjella prej tyre mbi çdo aktivitet të përcaktuar. Gjithashtu, shkalla e zbatimit të masave është përcaktuar në bazë të intervalit:

- ✓ **E zbatuar:** masa e cila është përmbushur në vlerën 40-100%;
- ✓ **E pazbatuar:** masa e cila nuk ka pasur zhvillim dhe progres për periudhën raportuese (vlera e raportuar 0%-40%).

Përcaktimi i nivelit të realizimit të OS është përlllogaritur si mesatarja e përqindjes së zbatimit të masave përkatëse. Analiza në nivelin e mesatares së përqindjes së zbatimit të masave pasqyron në mënyrë më të drejtpërdrejtë arritjet lidhur me Objektivat Specifikë në vitin 2023.

Përcaktimi i nivelit të realizimit të Qëllimeve të Politikave është përlllogaritur si mesatarja e përqindjes së realizimit të Objektivave Specifikë përkatës.

➤ **Konsultimi publik i raportit të monitorimit dhe performances**

Një komponent i rëndësishëm i mirëqeverisjes që ndërlidhet me rritjen e cilësisë së llogaridhënies dhe transparencës së institucioneve publike si dhe forcimin e demokracisë është procesi i konsultimit publik. Tashmë korniza rregullatore për konsultimin publik është unifikuar dhe ka ndikuar në përmirësimin e transparencës dhe cilësisë së politikave. Prioritare mbetet përfshirja aktive e publikut dhe shoqërisë civile në proceset e politikëbërjes. Në përputhje me kriteret ligjore

për konsultimin publik, pas hartimit të draft raportit, Ministria e Drejtësisë e dërgoi në datën 15 prill 2024 dokumentin për konsultim pranë institucioneve raportuese dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe e publikoi draftin në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, ku caktohet dhe një adresë elektronike për marrjen e komenteve, në faqen e internetit www.drejtësia.gov.al, në menu www.drejtësia.gov.al/konsultime/ . Në përfundim të procesit konsultues, Ministria e Drejtësisë kreu reflektimin e komenteve/sugjerimeve relevante mbi draft raportin e monitorimit dhe vijoi me zhvillimin e një takimi të dedikuar, në kuadër të diskutimit të analizës së kryer, gjetjeve të raportit, vlerësimit të qëllimeve të politikës në prezencë të të gjithë institucioneve zbatuese dhe raportuese të planit të veprimit. Pas miratimit të raportit në Komitet Drejtues Sektorial, Ministria e Drejtësisë publikoi në faqen e tij zyrtare raportin në gjuhën Shqipe.

IV. PROGRESI I ECURISË

PERMBLEDHJE E ARRITJEVE DHE SFIDAVE KRYESORE

Në mënyrë të përmbledhur, viti 2023 ka shënuar disa arritje të rëndësishme, pozitive dhe inkurajuese në fushat kryesore të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur të cilat janë përkthyer në rezultate konkrete dhe kanë pasur impakt në disa drejtime në lidhje me katër Qëllimet e Politikave të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë. Gjithashtu, sfidat kanë qenë prezente në disa sektorë të cilat kanë ndikuar në performancën e ulët të të disa Objektivave specifike.

➤ Qëllimi i Parë i Politikës

“Parandalimi i veprave penale ndaj fëmijëve dhe të kryera prej tyre, përmes edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të shoqërisë dhe fëmijëve”.

- ✚ Sesionet informuese për nxënësit nga mësuesit e lëndës së Qytetarisë dhe mësuesit kujdestar vazhdojnë të zbatohen me sukses në institucionet e nivelit parauniversitar.
- ✚ Tre institucione që punojnë me dhe për fëmijët (MSHMS, DNJF dhe QPKMR) kanë informacione online të përditësuara e të publikuara me një gjuhë miqësore për fëmijët si dhe për të drejtat dhe shërbimet e drejtësisë miqësore për ta.

- ✚ Në përgjithësi ka mungesë informacioni nga institucionet që punojnë me dhe për fëmijët nëse prindërit/fëmijët përdorin informacionin online në faqet e tyre zyrtare.
- ✚ Gjatë vitit 2023, AKCESK në kuadër të objektivit strategjik për rritjen e sigurisë online të fëmijëve në hapësirën kibernetike në bashkëpunim me organizatën International Telecommunication Union (ITU), kanë zhvilluar fushata ndërgjegjësimi për të edukuar, fuqizuar dhe këshilluar fëmijët, punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve dhe prindërit, lidhur me kërcënimet me të cilat mund të përballen në internet.
- ✚ Janë zhvilluar takime të shumta nga oficerë të sigurisë në çdo shkollë (jo më pak se 4 takime në një vit shkollor) për parandalimin e veprave penale ndaj fëmijëve dhe të kryera prej tyre. Por këto takime nuk janë zhvilluar bazuar në një calendar vjetor.
- ✚ Ende nuk ka një strategji komunikimi me fokus fëmijët që nuk ndjekin arsimin dhe prindërit e tyre, si dhe fëmijët në rrezik braktisje të arsimit të detyruar për të drejtat e tyre, për parandalimin e veprave penale ndaj fëmijëve dhe të kryera prej tyre dhe për shërbimet e drejtësisë miqësore për çdo fëmijë.
- ✚ Ka mungesë të kapaciteteve të punonjësve të reja të Njësive të Mbrojtjes së Fëmijëve nëpër bashki mbi tematika që lidhen mbi çështje të prindërimit dhe të ndërveprimit prindër-fëmijë.
- ✚ Janë bërë hapa pozitivë në drejtim të përmirësimit të instrumentave për dhënien e informacionit online me një gjuhë miqësore për çdo fëmijë nga të gjithë institucionet që ofrojnë shërbime për fëmijë, duke marrë në konsideratë veçanërisht nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- ✚ Janë zhvilluar programe informuese dhe edukuese për fëmijët në mediat audiovizive kombëtare dhe lokale, me pjesëmarrjen e fëmijëve, veçanërisht në RTSH
- ✚ Ka mungesa të zbatimit të programeve të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimin në shkolla dhe në komunitet.
- ✚ Komisioneri për mbrojtjen nga Diskriminimi ka zhvilluar aktivitete informuese dhe ndërgjegjësuese me fokus qasjen tek shërbimet e drejtësisë miqësore në çdo kohë për çdo fëmijë.
- ✚

➤ Qëllimi i Dytë i Politikës

“Një kuadër ligjor, institucional dhe me profesionistë që mundësojnë një drejtësi miqësore për çdo fëmijë”.

- ✚ Gjatë vitit 2023 nuk është përmirësuar asnjë ligj ose akt nënligjor në fushën penale, civile, familjare, administrative me fokus respektimin e të drejtave dhe interesit më të lartë të fëmijës, të drejtën për pjesëmarrje dhe për t'u dëgjuar në proces, efektiviteti i proceseve dhe ndjeshmëria e procedurave ku fëmija merr pjesë ose ku vendimmarrja ndikon mbi të.
- ✚ 60 vendime të detyrimeve ushqimore janë të ekzekutuara nga totali 9,899 çështje me objekt "pension ushqimor" dhe "takim me fëmijë" dhe "Kujdestari fëmijë".
- ✚ KMD ka trajtuar 18 ankesa me subjekte fëmijët në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Nga ankesat e trajtuara, Komisioneri ka konstatuar: 5 vendime pushimi për të cilat është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ato i ishin nënshtruar procedurave të shqyrtimit administrativ; 1 vendim ku KMD ka konstatuar diskriminimin e fëmijëve të cilat vijnë nga familje në nevojë; 3 vendime mosdiskriminimi; ndërsa për 9 ankesa të tjera Komisioneri vijon procedurat e shqyrtimit të tyre gjatë vitit 2024.
- ✚ Avokati i Popullit, ka hartuar dhe adresuar 3 rekomandime miqësore për gjykatat në çështjet me interes për fëmijët.
- ✚ Ende nuk është kryer studim mbi kuadrin ligjor lidhur me problematikat e hasura në praktikë dhe sugjerime të modeleve pozitive rajonale dhe të vendeve të BE-së të përshatshme për Shqipërinë.
- ✚ Kodi i Ri i Transmetimit ka hyrë në fuqi me vendimin e AMA-s nr. 60, datë 10.07.2023 dhe përmban 11 seksione, kundrejt 8 seksioneve që përmbante Kodi paraardhës. Në këtë Kod të ri një seksion është i dedikuar specifikisht rregullimit të imazhit të transmetuar të fëmijës në mediat audiovizive (Seksioni 4 i Kodit (Fëmijët në Transmetimet Audio dhe Audiovizive).
- ✚ AMA përmes Këshillit të Ankesave, ka realizuar në periudhën 2022-2023 12 tryeza konsultuese me operatorët e shërbimeve të mediave audiovizive në të gjitha qarqet e RSH-së.
- ✚ Ende nuk është hartuar një udhëzues që përcakton qartësisht definicionin "interesi më i lartë i fëmijës".
- ✚ SHM ka nisur marrjen e masave për realizimin e evidentimit të programeve që trajtojnë çështjet e drejtësisë për të mitur. Konkretisht është duke u punuar si në aspektin teknik, duke krijuar një nënfaqe të posacme për evidentimin e aktiviteteve për të miturit, edhe në aspektin akademik, për të grupuar temat, si në Programin e Formimit Fillestar edhe në atë Vazhdues, që trajtojnë aspekte të ndryshme të drejtësisë për të mitur.

- ✚ Bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, në çdo prokurori, për kategori të caktuara veprash penale, kur është e mundur dhe e nevojshme, drejtuesi i prokurorisë krijon seksione me jo më pak se tre prokurorë, bazuar ndër të tjera, në numrin dhe specializimin e prokurorëve, llojin, përhapjen dhe kategoritë e veprave penale, subjekteve, si dhe në rekomandimet e Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit. Seksioni i posaçëm për të miturit ngrihet, në çdo rast, në prokuroritë pranë gjykatave në të cilat janë krijuar sipas ligjit seksionet përkatëse për gjykimin e të miturve.
- ✚ Ngritja dhe caktimi i prokurorëve të specializuar në seksionet e të miturve, është bërë e mundur **në 11 prokurori pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm** (Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Fier, Lezhë, Korçë, Gjirokastrë, Vlorë, Berat, Sarandë), ndërsa në 2 prokurori (Kukes, Diber) është caktuar një prokuror për të ndjekur çështjet me të mitur sipas parashikimeve të KDPM.
- ✚ Trajnimi i mbrojtësve ligjorë të zgjedhur ose të caktuar në teknikat e mbrojtjes miqësore të fëmijës dhe komunikimit nuk është raportura ngja DHKA për vitin 2023.
- ✚ Nuk është kryer matja e kënaqësisë së fëmijëve në lidhje me nivelin e shërbimeve të ofruar nga mbrojtësit ligjorë përmes formularëve të dedikuar.
- ✚ Forcimi i kapaciteteve të psikologëve ndihmës / asistues/ trajtues të rasteve në pyetjet për fëmijët dhe formulimin e tyre nuk është kryer gjatë viti 2023.
- ✚ Vazhdon me sukses forcimi i kapaciteteve të punonjësve të Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve. Këto trainime janë kryer më së shumti nga UNICEF dhe OSCE në Shqipëri.
- ✚ Ende nuk është finalizuar bashkepunimi midis ASHDMF, SHM dhe Urdhërit të Psikologut me qëllim përfshirjen në trajnimet të grupit shumëdisiplinar.
- ✚ Janë kryer disa trainime për punonjës të SHP që trajtojnë çështje të të miturve por këto janë shumë të limituara. Kjo për arsye të mungesës së buxhetit në lidhje me organizimin e trainimeve në këtë fushë.
- ✚ Mungesa e buxhetit të DPP për ngritjen e kapaciteteve të punonjësve të shërbimit përbarimit gjyqësor që trajtojnë çështje të fëmijëve ka sjellë mosrealizimin e kësaj mase të startegjisë.
- ✚ MD nuk ka caktuar ende të paktën 2 punonjës të dedikuar, pjesë e Drejtorisë që mbulon Strategjitë dhe Politikat në Fushën e Drejtësisë në MD, të cilët duhet të punojnë me kohë

të plotë dhe të dedikuar me çështje që lidhen me fëmijët dhe koordinimin institucional për zbatimin e Strategjisë për të Mitur 2022-2026.

- ✚ 2 staf i MD-së janë trainuar për konsolidimin e statistikave dhe përgatitjen e raportit të monitorimit të SDM 2022-2024.
- ✚ Aksesimi i kufizuar i QPKMR në Sistemin e Integruar të të Dhënave Penale për të Mitur në konflikt me ligjin nuk lejon marrjen e të dhënave statistikore të hedhura nga institucionet përgjegjëse, sipas indikatorëve të ndryshëm. Si rrjedhojë, nuk ka raporte të mirëfillta të gjeneruara nga sistemi i integruar i të dhënave penale të fëmijëve në konflikt me ligjin. Të dhënat e mbledhura gjatë vitit 2023 janë të dhëna të mbledhura manualisht nga disa institucione që janë përdorues të sistemit të integruar por këto të dhëna nuk janë të plota.

➤ Qëllimi i Tretë i Politikës

“Garantimi i qasjes në çdo kohë në drejtësinë miqësore për çdo fëmijë. Garantimi i qasjes në çdo kohë në drejtësinë miqësore për çdo fëmijë”.

- ✚ Gjatë vitit 2023 kanë përfituar ndihmë juridike falas 399 të mitur në konflikt /kontakt me ligjin. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas nuk i ndan të dhënat sipas gjinisë, vendndodhjes apo çështjeve.
- ✚ Për vitin 2023 janë realizuar 334 takime/fushata për informimin/ndërgjegjësimin në lidhje me ndihmën juridike falas të dedikuara për të gjitha llojet e kategorive përfituese të ligjit. Në këto fushata kanë përfituar edhe fëmijë në konflikt/kontakt me ligjin krahas kategorive të tjera përfituese të ligjit.
- ✚ Organizata të ndryshme të licensuara nga MD kanë ngritur ekipe lëvizëse në terren për informimin dhe ofrimin e ndihmës juridike. Nuk saktësohen zonat ku këto ekipe ofrojnë këtë ndihmë.
- ✚ Nuk raportohen nga DNJF ekipe të lëvizshme në terren që ofrojnë ndihmë juridike falas.
- ✚ Nuk është realizuar përgatitja me një gjuhë dhe format miqësor, botimi, publikimi dhe shpërndarja e kartës së të drejtave të fëmijës në kontakt/ konflikt me ligjin.
- ✚ DHKA raporton se janë hartuar dhe janë dërguar listat e avokatëve të specializuar që ofrojnë ndihmë juridike detyësore për fëmijët në prokurori dhe gjykata si dhe në Ministrinë e Drejtësisë.

- ✚ Nuk raportohen aktivitete që lidhen me vlerësimin e cilësisë së shërbimeve për fëmijët në komisariatet e policies; Përdorimi i manualeve të intervistimit dhe i teknikës së të intervistuarit të fëmijës në polici dhe mirëmbajtja e tyre – masa të cilat, bazuar në strategji, duhet të kishin filluar së implementuari në vitin 2023.
- ✚ DPPSH raporton se Njësitë Miqësore të Intervistimit me të Mitur janë marr në administrim dhe mirëmbajtur nga DVP që i kanë pasur në përdorim gjatë vitit 2023.
- ✚ DPPSH ka shpërndarë në cdo DVP gjatë vitit 2022, Manuale për Metodën e Hetimit dhe Intervistimit me të Mitur, të gjithë punonjësve të policisë që janë trajnuar për temat që lidhen me hetimin e veprave penale me të mitur, intervistimin e të miturve apo përdorimin e njësive të intervistimit me të mitur. Këto manuale kanë shërbyer si orientim për cdo Specialist të Hetimit të Krimit në komisariatet e policisë, në rastet e intervistimit me të mitur.
- ✚ Për shkak të ndryshimeve strukturore të Policisë së Shtetit gjatë vitit 2023, në komisariatet e policisë nuk ka më specialist të dedikuar që trajtojnë rastet e dhunës në familje dhe të miturit, por cdo Specialist i Hetimit të Krimit, është përgjegjës për trajtimin e të gjitha rasteve me të mitur, sipas zonave policore të përcaktuara nga struktura hierarkie. Si rrjedhim, jo të gjithë Specialistët e Hetimit të Krimit janë të njohur dhe kanë në përdorim Manuale për Metodën e Hetimit dhe Intervistimit me të Mitur.
- ✚ DPPSH ka 15 Njësi Miqësore të Intervistimit me të Mitur, (**Kamëz, Vorë, Krujë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Lezhë, Vlorë, Berat, Gjirokastrë, Dibër, Kukës, Fier, Korçë dhe Sarandë**), të cilat janë në përdorim të drejtorive vendore/komisariateve të policisë. Këto njësi janë të pajisura me sistemin video-audio të intervistimit të të miturve, të ofruar nga OJF.
- ✚ DPPSH nuk ka pasur një buxhet të posaçëm për investimet, që lidhen me mirëmbajtjen e kushteve fizike të njësive të intervistimit me të mitur, përditësimin e sistemeve të video-audio të tyre apo blerjen e licensave të programeve kompjuterike. DPPSH po planifikon me strukturat e brendshme (Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit) përcaktimin e një buxheti të posaçëm për mirëmbajtjen e Njësive të Intervistimit me të Mitur.
- ✚ DPPSH ka vlerësuar problematikën e sigurimit të shërbimit edhe për personat me aftësi të kufizuara dhe aksesueshmërinë e ambienteve të ZSHQ-të (Zyrat në Shërbim të Qytetarëve) prej tyre. Në përgjithësi të gjitha ZSHQ-ve, janë të aksesueshme nga personat P.A.K, po

ashtu edhe struktura qendrore e policisë DPPSH dhe ato vendore, me përjashtim të disa DVP të cilat për shkak të konstruksionit të favorshëm, kanë aksesueshmëri të drejtëpërdrejtë në ambientet e ZSHQ-të (Zyrat në Shërbim të Qytetarëve). Në të gjitha objektet e reja të projektuara e ndërtuara, si dhe ato të rikonstruktura është vënë si kusht dhe është plotësuar infrastruktura e nevojshme për personat me aftësi të kufizuara.

- ✚ Në kushtet kur harta gjyqësore nisi implementimin në maj 2023, në kuadër të adresimit të problematikave që kanë prokuroritë lidhur me mjedise të kufizuara për shkak të bashkimit të tyre dhe nevojës për ambiente të reja, ende nuk janë percaktuar standardet e mjediseve miqësore dhe të përshtatshme për fëmijët në prokurori, përfshirë personat me aftësi të kufizuara.
- ✚ Ka problematika në lidhje me sigurimin e ambienteve për ushtrimin e funksioneve të SHP dhe institucioneve të saj të varësisë e cila vjen si pasojë e mungesës së fondeve të nevojshme për këtë qëllim.
- ✚ Për vitin 2023 është mundësuar realizimi i standardeve të mjediseve miqësore dhe të përshtatshme për fëmijët në zyrat e shërbimit përmbartimor gjyqësor, përfshirë personat me aftësi të kufizuara pasi është mundësuar evidentimi i nevojës për përmirësim të infrastrukturës në 22 zyrat vendore, konkretisht për sistemim me ambiente të përshtatshme për kryerjen e veprimtarisë së tyre, e për rrjedhojë edhe të ekzekutimit të titujve ekzekutivë me objekt fëmijët.
- ✚ Ende nuk janë krijuar mjedise miqësore për fëmijën në zyrën e përmbartimit gjyqësor Tiranë.
- ✚ Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit, në zbatim të detyrimeve ligjore në fillim të vitit 2023 ka kryer procesin e identifikimit dhe vlerësimit të nevojave për burimet njerëzore të nevojshme për përmbartues gjyqësor si dhe për staf mbështetës, psikolog, punonjës social etj, jo vetëm për të garantuar ekzekutim të çështjeve që kanë të bëjnë me të miturit, por edhe për të garantuar ekzekutimin e të gjithë çështjeve të tjera përmbartimore, të rezultuara për ekzekutim pranë këtij shërbimi. Dhe bazuar në këtë vlerësim, me Urdhërin nr. 447, datë 10.07.2023 "Për percaktimin e numrit të përgjithshëm të përmbartuesve gjyqësorë të Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror", ka miratuar se numri i përgjithshëm i përmbartuesve gjyqësorë shtetëror duhet të jetë 144. Por në Strukturën e Miratuar me Urdhër nr.222 datë 14.12.2023, është ulur numri i përmbartuesve dhe nuk ka psikologë të shtuar në strukturën e Institucionit. Organika aktuale me vetëm 74 përmbartues gjyqësor,

në raport me ngarkesën e punës për përmbarues e cila është shumë e lartë dhe pa specialist psikolog në strukturë, ka ndikim të drejtpërdrejt në mosgarantinimin e ofrimit cilësor të shërbimit.

- ✚ **12 prokuri te rretheve gjyqesore** Tiranë, Durrës, Shkodër, Kukës, Dibër, Vlorë, Elbasan, Korçë, Lezhë, Fier, Berat, Gjirokastrë kanë ngritur një strukturë të dedikuar pranë tyre për ofrimin e shërbimeve psikologjike
- ✚ Me ndryshimet strukturore gjatë vitit 2023, psikologët të emëruar në strukturën e Policisë së Shtetit, pranë Drejtorive Vendore të Policisë do të japin shërbimin psikologjik vetëm për punonjësit e policisë dhe nuk do të shërbejnë për asistencë psikologjike gjatë trajtimit të rasteve të intervistimit me të Mitur. Këto raste do të asistohen nga psikolog të trajnuar për drejtësinë penale me të Mitur dhe të licensuar nga Urdhri i Psikologut.

➤ **Qëllimi i Katërt i Politikës**

“Drejtësi penale që mundëson parandalimin e ripërfshirjes së fëmijës në kryerjen e veprave penale, rishoqërimin dhe ri-integrimin e fëmijëve në kontakt/konflikt me ligjin”.

- ✚ **30% e fëmijëve në kontakt/konflikt me ligjin** kanë përfituar shërbime ri-integruese në shoqëri gjatë vitit 2023. Nga 17 të mitur që kanë dalë nga IM Kavajë përgjatë vitit 2023, 5 prej tyre kanë përfituar kurse profesionale dhe shërbime konkrete nga QPKMR. Pjesa tjetër e të miturve janë nën masën e sigurisë "arrestë shtëpie" dhe e kanë të pamundur të ndjekin apo frekuentojnë aktivitete apo shërbime që ofronë QPKMR.
- ✚ PP raporton se në kuadër të raportit vjetor, analizohet në mënyrë të veçantë zbatimi i masave alternative të shmangies dhe politika penale ndaj të miturve. Me qëllim konsolidimin dhe shpërndarjen e praktikave më të mira, Qendra për Zhvillim pranë PP, po rishikon Udhëzuesin për prokurorët, hartuar në vitin 2022, për ta pasuruar me raste të tjera nga praktika e zbatimit të masës së shmangies.
- ✚ Shkolla Magjistraturës ka zhvilluar 5 trajnime të cilat prekin fushën e drejtësisë për të mitur gjatë vitit 2023. Në këto trainime kanë marrë pjesë 16 magjistratë (7 gjyqtarë dhe 9 prokurorë). Konkretisht, aktivitetet trajnuar më datë 27-28 shkurt 2023, me temë "Zbatimi i masave mjekësore dhe edukuese".

- ✚ QPKMR ende nuk ka nisur të bëjë një vlerësim të shkallës së ripërfshirjes në krim të të miturve/të rinjve.
- ✚ Gjatë vitit 2023 janë trajnuar **79 punonjës policie** për tema që lidhen me zbatimin e drejtësisë penale për të mitur dhe janë trajnuar 39 punonjës policie për tema që lidhen me drejtësinë restauruse dhe ndërmjetësimin, në trajtimin e konflikteve të të miturve nëpër shkolla, sipas Programit të Punës "Për zbatimin e prioriteteve dhe objektivave të përcaktuara nga Ministri i Brendshëm në paketën e sigurisë për shkollat, 2023-2024".
- ✚ Me riorganizimin dhe ndryshimet strukturore të vitit 2023 në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit në 11 Drejtoritë Vendore të Policisë, në Sektorin për Krimet në Volum, ka 1 funksion organik "Specialist për dhunën në familje dhe mbrojtjen e të miturve".
- ✚ **31 të mitur janë raportuar ne total: të paraburgosur (27) dhe të dënuar (4)** gjatë vitit 2023; 3 (tre) të etnisë Rome, 6 (gjashtë) të etnisë egjiptiane, 1 (një) i shtetësisë kosovare dhe 21 shqiptarë
- ✚ **183 fëmijë (14-18 vjeç) janë trajtuar** nga Zyrat Territoriale të Shërbimit të Provës gjatë vitit 2023. Këta janë raste të të miturve me masë shmangieje ose masë alternative të dënimit me burgim, si dhe hartim të Raportit të Vlerësimit Individual për të miturin në konflikt me ligjin. Ndarë si më poshtë: 57 raste të hedhura gjithsej për masat e dhëna me dënim alternativ për periudhën Janar – Dhjetor 2023.
- ✚ Nuk janë rishikuar kriteret për hapjen e kurseve të formimit profesional për fëmijët në konflikt me ligjin.
- ✚ **DPB raporton se gjatë vitit 2023 dhe në vazhdim** ka qenë në proces hartimi i një marrëveshje bashkëpunimi me AKPA me qëllim fuqizimin e formimit profesional në sistemin e burgjeve përfshirë edhe të burgosurit e mitur. Gjithashtu, është në proces miratimi i një udhëzimi të përbashkët ndërmjet MD dhe MFE për arsimin dhe formimin profesional të të burgosurve, proces që po koordinohet nga MD. DPB ka hartuar gjithashtu një draft MoU për arsimin e të burgosurve. Drafti është dërguar në MD për koordinim me MAS për finalizimin e draftit të MoU.
- ✚ Manuali për detyrat e punonjësit të angazhuar në veprimtari e rekreacionit të fëmijëve në konflikt me ligjin është hartuar në bashkëpunim me CARITAS Shqipëri dhe është miratuar në DPB me Urdhër nr.123, datë 24.01.2024.

- ✚ SHSSH në bashkëpunim me mbështetjen e partnerëve të programit LNB2, organizata PNUD ka realizuar në qershor 2023 " Hartëzimi i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror".
- ✚ Ende nuk është kryer një studim në lidhje me ripërfshirjen e të rinjve në krim.
- ✚ **7 marrëveshje të reja të bashkëpunimit** janë nënshkruar nga QPKMR me të gjitha institucionet e përfshira në zbatimin e programeve të rehabilitimit dhe riintegrimin të të miturve në konflikt me ligjin. Institucionet me të cilat janë nënshkruar marrëveshjet janë si më poshtë:
 1. Marrëveshje me Qendrën e Rehabilitimit për Çrregullimet Adiktive ALBA NOSTRA SALUS;
 2. Marrëveshje me Qendrën ACT FOR SOCIETY;
 3. Albanian Initiative for Development;
 4. Marrëveshje me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve;
 5. Marrëveshje me Urdherin e Punonjësit Social;
 6. Marrëveshje me ASHDMF;
 7. Qendra "Brain Bee"
- ✚ Duke marrë parasysh që QPKMR e ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë Republikën e Shqipërisë, numri i stafit është shumë i vogël krahasuar me numrin e shkollave në të cilat shihet e nevojshme që të zhvillohen sesionet sensibilizuese për drejtësinë penale për të mitur.
- ✚ Nuk ka një buxhet të dedikuar në institucionin e DNJF për secilën nga kategoritë përfituese të ligjit nr.111/2017, *“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”*, buxheti i DNJF-se, është i parashikuar në tërësi për gjithë fushën e veprimtarisë së saj.
- ✚ Gjatë vitit 2023 ka qenë në proces konsultimi të brendshëm në PP mundësia që nëpërmjet një qarkoreje ose ndërhyrje në akte nënligjore të nxitet aplikimi i masave të tjera alternative në përputhje me nevojat e të miturit dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale.
- ✚ Gjatë vitit 2023, nga të dhënat statistikore të prokurorive rezulton të jenë aplikuar **ndaj 3 të miturve masa detyruese**; janë aplikuar ndaj **2 të miturve këshillimi si masë shmangie**.
- ✚ Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur në konflikt/kontakt me ligjin **nuk funksionon plotësisht**. Kjo si pasoje e problemeve në “akses” të krijuara nga

AKSHI. Ky ngërç në aksesin e sistemit ka sjell për pasoje një varg problemesh si: i. Gjykatat nuk kanë filluar ende të përdorin Sistemin e Integruar të të Dhënave Penale për të Mitur në konflikt me ligjin. Nxjerrja e Udhëzimit Nr. 427, datë 14.10.2022 “Për përdorimin dhe hedhjen e të dhënave në Sistemin e Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur”, nga KLGJ konsiderohet zhvillim pozitiv i cili do të sjellë popullimin e sistemit me të dhënat që gjeneron gjykata. Implementimi i hartës së re gjyqësore ka sjellë ndryshime tek përdoruesit e gjykatave dhe prokurorive si pasojë e ndryshimeve në shtrirjen e kompetencave tokësore të këtyre gjykatave; ii. Pamundësia e ofrimit të trainimeve dhe mentorimit të administratorit të Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur si dhe të të gjithë mbikëqyrësve dhe përdoruesve të institucioneve si: Polici, Prokurori, Gjykatë, Shërbim Prove, Burgje dhe QPKMR. Kjo mbështetje është e nevojshme për të patur një efektivitet të lartë të Sistemit të Integruar. Në disa institucione ka mbikëqyrës të rinj të patrajnuar më pare; iii. Pamundësia e gjenerimit të raporte statistikore të cilat duhet të publikohen çdo vit nga MD etj.

- ✚ Grupi (rrjeti) i profesionistëve në nivel vendor që punojnë me dhe për fëmijën, në 7 bashki¹ të vendit nuk është krijuar ende.

➤ Vlerësimi i sfidave, hapat në vijim

Mbështetur në rezultatet e monitorimit të kryer për periudhën *1 janar – 31 dhjetor 2023*, rezulton se fushat që kanë treguar performancë jo të mirë për këtë periudhë raportimi janë aktivitet e pa realizuara/pazbatuara.

Në adresimin e performancës nga institucionet, rezulton se mungesa e burimeve njerëzore specifike (kapacitete institucionale); mungesa e buxheteve specifike për kryerjen e disa veprimtarive të parashikuara; janë arsye dhe shkaqe që kanë çuar në mosrealizim të objektivave të parashikuar për periudhën e raportimit.

Me qëllim përmirësimit të zbatimit dhe rritjes së impaktit të Planit të Veprimit 2022-2023, sfidat e rëndësishme për periudhat vijuese të zbatimit dhe të monitorimit janë:

- ✚ Informacioni i raportuar duhet të përpunohet dhe dërgohet në përputhje me masën e caktuar për zbatim, të jetë faktik, të ketë evidenca të qarta dhe të dhëna analitike. Çdo qëllim

¹ Berat, Gjirokastrë, Pukë, Shkodër, Lezhe, Fier, Tiranë

politikash duhet të ndërlihet me nivelin e zbatueshmërisë së masave/aktiviteteve dhe buxhetin e planifikuar dhe të buxhetit faktik të përdorur.

- ✚ Rritja e ndërgjegjësimit të institucioneve përgjegjëse të përfshira në Planin e Veprimit lidhur me rëndësinë që paraqet puna e vazhdueshme për zbatimin e duhur dhe në kohë të PV, si dhe mbi rëndësinë e procesit të raportimit.
- ✚ Rritja e nivelit të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies nga strukturat e brendshme të institucioneve përgjegjëse edhe nëpërmjet fuqizimit të koordinimit ndërinstitucional.
- ✚ Rakordimi i informacionit të marrë nga pikat e kontaktit tek Drejtoritë e Financës, përpara momentit të raportimit.
- ✚ Kryerja e procesit të monitorimit periodik, diskutimit të gjetjeve dhe miratimit të raporteve respektive sipas afateve të raportimit të parashikuara në Strategji.
- ✚ Mungesa e raportimit shumë të rëndësishëm lidhur me Treguesit e Performancës

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën *janar - dhjetor 2023*, të gjetjeve që ky dokument na ofron, të të dhënave analitike që institucionet kanë raportuar dhe të analizës së kryer, kërkohet që:

- ✚ Të vijojë zbatimi i masave në statusin “zbatuar pjesërisht/në proces” sipas afateve të parashikuara;
- ✚ Të nisë zbatimi në kohë i masave/aktiviteteve të parashikuara për periudhën në vijim;
- ✚ Të tregohet kujdes për organizimin e punës dhe proceseve përkatëse për ecurinë e masave e aktiviteteve;
- ✚ Të sigurohet operativiteti i burimeve dhe kapaciteteve njerëzore dhe ekspertizës së nevojshme për kryerjen e tyre;
- ✚ Dërgimi i informacionit mbi disbursimin financiar për aktivitetet e parashikuara në strategji, pasi ndikojnë në pasqyrimin jo real të kostove për zbatimin e Strategjisë;
- ✚ Të sigurohet bashkëpunimi institucional i nevojshëm për masa e aktivitete të përbashkëta;
- ✚ Të garantohet koordinimi i mjaftueshëm për të shkëmbyer në mënyrë të efektshme informacionin dhe zgjidhur problemet penguese që mund të zgjidhen nga institucionet (përgjegjëse dhe bashkëpunëto).